



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 277 prot.

Tiranë, më 19 / 11 /2024

Lënda: Raport informues për identifikimin e viktimave të regjimit komunist në *Fjalorin Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist*, botim i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit

KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Znj. Elisa Spiropali

KOMISIONI PËR EDUKIMIN DHE MJETET E INFORMIMIT PUBLIK

Znj. Ina Zhupa

Në zbatim të nenit 5, të Ligjit nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri” (ISKK), Instituti ka përgatitur një raport informues për numrin total të viktimave të regjimit komunist, ku përfshihen të persekutuarit e të gjitha kategorive, përfshi të vrarët gjatë periudhës 1 janar 1942 – 29 nëntor 1944. Këto të dhëna janë bazuar në *Fjalorin Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist*, 12 vëllime, botim i ISKK.

BAZA LIGJORE

ISKK është krijuar nga Kuvendi i Shqipërisë, me Ligjin nr. 10242, 25 shkurt 2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”. Detyrat kryesore të ISKK, parashikuar në këtë ligj, janë:

Neni 5:

- a) studion dhe vlerëson objektivisht periudhën e regjimit komunist;
- b) analizon, studion dhe dokumenton krimet e kryera nga organet e diktaturës komuniste, si dhe pasojat gjatë dhe pas periudhës së komunizmit;
- c) identifikon aktet ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga të gjitha institucionet, organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;
- c) studion dhe vlerëson ndërtimin, organizimin institucional dhe veprimtarinë antidemokratike e kriminale të strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit;
- d) studion dhe vlerëson veprimtarinë kriminale të Partisë Komuniste të Shqipërisë, më pas të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të organizatave të tjera, të krijuara në mbështetje të ideologjisë së saj;
- dh) analizon shkaqet dhe rrugët e vendosjes së regjimit komunist, dokumentet, që vërtetojnë përfshirjen e personave shqiptarë a të huaj, që mbështetën ardhjen e këtij regjimi, si dhe të atyre, të cilët bënë rezistencë kundër këtij regjimi;
- e) grumbullon të dhëna, dokumente dhe dëshmi për ndriçimin e veprimtarisë së organeve dhe të strukturave të Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive, që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;
- ë) evidenton personat, që kanë qenë pjesë e organeve apo autoriteteve vendimmarrëse, përgjegjëse për propagandën komuniste, për aktet administrative dhe vendimet, të cilat kanë çuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, në veprime represioni, në jetën shoqërore dhe kulturore, përfshirë luftën e klasave, kolektivizimin, luftën kundër fesë, izolimin nga Perëndimi, pamundësinë për t'u informuar dhe censurën në art, kulturë e shkencë, si dhe kufizimin e furnizimit me ushqime, përmes tallonave të ushqimit;
- f) vë në dijeni publikun për krimet dhe rrjedhojat e tjera të luftës së klasave;
- g) sistemon dhe boton kujtimet e të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;
- gj) përpunon, në formë elektronike, të gjithë dokumentacionin për krimet e regjimit komunist në Shqipëri;
- h) publikon dhe përhap materiale të shkruara, në letër dhe në rrugë elektronike, si dhe organizon ekspozita, seminare, konferenca e diskutime për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri;
- i) bashkëpunon me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së institutit;
- j) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të arsimit për përfshirjen, në planet dhe programet mësimore të shkollave të të gjitha niveleve, të informacionit të mjaftueshëm për krimet e komunizmit dhe të pasojave të tij në Shqipëri;
- k) bashkëpunon me institucionet homologe të huaja.

QËLLIMI

Ky raport ka për qëllimin informimin e Kuvendit të Shqipërisë për disa nga rezultatet e dala nga botimi i plotë të *Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist në Shqipëri*, një vepër studimore, enciklopedike.

OBJEKTI

Objekti i këtij raporti është evdientimi i numrit të përgjithshëm të viktimave të regjimit komunist dhe numri i përgjithshëm i të vrarëve nga komunistët në periudhën 1 janar 1942 – 29 nëntor 1944.

METODOLOGJIA

Ky raport informues bazohet në faktet e publikuara në *Fjalorin Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist (Fjalori, në vazhdim)*, një vepër me 12 vëllime, e botuar në periudhën 2012-2023.

Fjalori është një vepër studimore e karakterit enciklopedik. Qëllimi i *Fjalorit* ishte evidentimi i viktimave të regjimit komunist, në të gjitha kategoritë: vrasje, burgosje, internim, dëbim, etj. *Fjalori* ka pasur një redaksi të përhershme dhe një bord konsultativ, i cili përbëhej nga anëtarët e Këshillit Shkencor dhe Bordit të ISKK. *Fjalori* është përgatitur bazuar në metodat bazë që përdoren për realizimin e punimeve shkencore: hulumtimi, përshkrimi, krahasimi, sinteza dhe analiza. Faktet e paraqitura në *Fjalor* janë bazuar në dokumente zyrtare, vendime ekzekutimi, vendime gjykatash, vendime të Komisionit të Internim-Dëbimit, vendime të Komisionit Trepalësh, krijuar me Ligji nr. 7748, 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, dokumente të tjera arkivore ose të botuara, përmbledhje dokumentare, kujtime, ditarë, dokumente zyrtare si listat e dëshmpërblimit të të përndjekurve politikë, etj.

Në *Fjalor* janë prezantuar personat që kanë vuajtur persekutim gjatë regjimit komunist dhe gjatë periudhës që çoi në marrjen e pushtetit nga komunist. Çdo person është identifikuar me emër, atësi, mbiemër, datën e lindjes, vendlindjen, dhe llojin e persekutimit. Këto të dhëna nuk janë të plota në të gjitha rastet, por janë në pjesën dërrmuese të tyre. Ka raste kur mundon atësia, kur mungon data e lindjes, kur mungon vendlindja, por këto raste janë të pakta. Rregulli ka qenë që personat që do të përfshiheshin në *Fjalor* duhet të kishin informacion të mjaftueshëm për identifikimin e tyre dhe të persekutimit.

GJETJE SIPAS FJALORIT ENCIKLOPEDIK TË VITKIMAVE TË TERRORIT KOMUNIST

Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist ka 4.831 faqe, ndarë në 12 vëllime, botuar në harkun kohor 2012-2023. Shtypshkrimi i tij është financuar nga Fondacioni Konrad Adenauer Tiranë.

1.

Sipas *Fjalorit*, janë persekutuar gjithsej, në të gjitha kategoritë – të ekzekutuar, të burgosur, të internuar, të dëbuar, etj., – 46.572 persona.

Mendojmë se shumica e viktimave të komunizmit janë përfshirë në *Fjalor*. Për realizimin e tij është bërë një punë e madhe kërkimore, por, sigurisht, që ka ende persona të tjerë për tu identifikuar.

Puna do të vazhdojë. Së shpejti, *Fjalori* do të kalojë në formë *digital-e* dhe do të jetë interaktiv, që qytetarët e interesuar të dërgojnë informacion, i cili do të verifikohet dhe mandej do të përfshihet në *Fjalor*.

Në *Fjalor* ka disa njësi (emra) që mund të jenë të dubluara, por janë një numër i papërfillshëm. Kjo ka ndodhur për arsye se ka dokumente ku i njëjti person shfaqet me emrin e babait si mbiemër, gjë që ndodhte në traditën shqiptare, dhe në dokumente të tjera është gjetur me mbiemrin e familjes. Aty ku kemi mundur t'i identifikojmë i kemi shmangur këto dublime, por ka raste që janë botuar. Sidoqoftë, kjo është në shifra minimale dhe do të shmanget në variantin *digital*.

Mendojmë që pas plotësimit, në të ardhmen, të ketë një botim tjetër, të plotësuar.

2.

Sipas *Fjalorit*, të vrarë nga komunistët, në periudhën 1 janar 1942 – 29 nëntor 1944, janë 2.254 persona.

(Parantezë: Data 1 janar 1942 është datë e përdorur vetëm për qëllimet e numërimit të të vrarëve të luftës, nisur nga fakti që viktimat e para të komunistëve shfaqen në pranverë të vitit 1942. Për këtë rat, kemi përdorur metodën e gjykatave, të cilat kur nuk e përcaktojnë dot një datë përgjatë një viti, ato vendosin si kufij datën e parë të vitit dhe datën e fundit të tij.)

Kjo është hera e parë që bëhet një identifikim i plotë i këtyre personave, të lënë në harresë nga qeveritë shqiptare në periudhën 1944-1991. Kjo shifër ka dalë pasi janë pastruar dublimet e pakta që janë vënë re në *Fjalor*.

Për herë të parë, institucionet treguan kujdes për këta persona me Ligjin nr. 7748, 29.7.1993, “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”.

Këto persona janë viktimat e luftës civile, mes Partisë Komuniste Shqiptare (PKSH) dhe partive të tjera politike Balli Kombëtar (BK), Legalitetit dhe grupimeve të tjera jashtë influencës së PKSH.

Gjatë regjimit komunist dhe në dekadat e para të rënies së komunizmit ka vazhduar të shkruhet narrativa komuniste për periudhën e Luftë së Dytë Botërore, sipas së cilës komunistët luftuan për çlirimin e Shqipërisë dhe gjithë të tjerët ishin tradhtarë, reaksionarë, kolaboracionistë, etj..

Më 2015, ISKK botoi librin “Lufta civile, 1943-1945”, me autor Uran Butkën. Deri atëherë për luftën civile kishin shkruar individë jashtë institucioneve.

Më 2021, Instituti i Historisë, tashmë pranë Akademisë së Shkencave, shkroi për herë të parë për luftën civile si një realitet historik, në veprën *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX* (1939-1944), Vëll. IV, faqe 302-389.

Lufta civile është fakt historik. Të vrarët nga komunistët, për të cilët po informojmë Kuvendin në këtë raport, nuk mund të anashkalohen më. Këto janë një pjesë e viktimave të luftës civile, viktimat e tjera janë shkaktuar nga forcat e Ballit Kombëtar, Legalitetit, etj., por ato janë të identifikuar dhe kanë status dëshmori.

3.

Të vrarët nga PKSH dhe njësitë ushtarake të saj kanë tipologji të ndryshme.

Pjesa më e madhe e 2.254 të vrarëve nga komunistët janë anëtarë, përkrahës ose luftëtarë të Ballit Kombëtar, Legalitetit, dhe formacioneve ushtarake jashtë lëvizjes komuniste. Një pjesë janë civilë, të cilët nuk kanë qenë pjesë e luftimeve ose e formacioneve ushtarake. Mes të vrarëve janë dhe komunistët e vrarë nga vetë komunistët.

Në listën e viktimave janë dhe ata që janë vrarë nga komunistët për llogari të të tretëve. Një rast i tillë është vrasja e Lllazar (Zai) Fundos, një komunist që kishte braktisur dogmën, i cili u vra me urdhër të Titos, drejtues i Partisë Komuniste Jugosllave, për llogari të Kominternit.

Në listë janë përfshirë dhe një numër i vogël personash të vrarë nga njësitë ushtarake italiane, siç janë të vrarët në Gërhot, Gjirokastër, 14 shtator 1943; ose gjermanët, siç është rasti i Skënder Muços, të cilët, edhe pse u vranë nga njësitë ushtarake të konsideruara pushtuese, regjimi komunist i la në harresë dhe familjet e tyre i persekutoi, sepse ata kishin qenë luftëtarë të Ballit Kombëtar.

Aty ku kemi mundur t'i identifikojmë, kemi bërë shpjegimin përkatës, dhe janë gjithsej 35 persona. Këta të vrarë nga formacionet pushtuese, jo vetëm që nuk iu dha status dëshmori, por nuk u trajtuan as si viktimat e luftës. Udhëzimi i Kuvendit të Shqipërisë, "Mbi dëshmorët e atdheut dhe varrezat e tyre", datë 18.10.1969, kishte këtë përcaktim për këta persona: "Në kategorinë e viktimave nuk hyjnë, p.sh., ata persona që nuk kanë qenë të organizuar në Lëvizjen nacional-çlirimtare dhe janë vrarë nga armiku rastësisht, ose i janë dorëzuar vullnetarisht armikut dhe ky i ka vrarë. Në asnjë mënyrë nuk mund të futen në kategorinë e viktimave ata persona që, duke qenë të inkuadruar në radhët e Ballit Kombëtar apo të Legalitetit, janë vrarë rastësisht nga armiku."

KONTEKST STATISTIKOR PËR TË VRARËT NË SHQIPËRI NË PERIUDHËN 7 PRILL 1939 – 29 NËNTOR 1944

Në periudhën 7 prill 1939-29 nëntor 1944 në Shqipëri vepruan shumë formacione ushtarake, të huaja dhe shqiptare, të cilat u përfshinë në luftime dhe natyrisht shkaktuan një numër të konsiderueshëm të vrarësh. Gjatë regjimit komunist, regjimi tregoi vëmendje vetëm për të vrarët në radhët e formacioneve ushtarake partizane/komuniste, të cilët i identifikoi, u dha status dëshmori, i dëshmipërbleu familjet e tyre ekonomikisht me pensionin e dëshmorit, etj. Në librin

Historia e shqiptarëve gjatë sheklullit XX (1939-1944), Vëll. IV, botim i Institutit të Historisë (2021), është publikuar një tabelë me të dhëna për të vrarët partizanë/komunistë. Më poshtë po japim tabelën përkatëse (Tabela 1), sipas botimit origjinal, dhe tabelën (Tabela 2) për të vrarët nga partizanët/komunistët:

1. *Tabela e partizanëve të vrarë (sipas Institutit të Historisë)¹*

Formacioni ndërluftues	Numri i partizanëve të vrarë
Gjermanë	1514
Gjermano-ballistë	275
Italianë	207
Ballistë, nacionalistë	1067
Nacionalistë nga Kosova	34
Aksidentalisht	35
Të vdekur	310

2. *Tabela e të vrarëve nga komunistët/partizanët (sipas ISKK)*

Formacioni ndërluftues	Numri i nacionalistëve, legalistëve, etj., të vrarë
Komunistët/partizanët	2254

Observime:

- Të vrarët në të dy tabelat janë qytetarë shqiptarë.
- Formacionet ndërluftuese që kanë vrarë më shumë qytetarë shqiptarë janë formacionet partizane/komuniste.
- Numri i qytetarëve të vrarë nga formacionet partizane/komuniste është 11 herë më i madh se numri i qytetarëve shqiptarë të vrarë nga formacionet e ushtrisë italiane.
- Numri i qytetarëve të vrarë nga formacionet partizane/komuniste është 1.5 herë më i madh se numri i qytetarëve shqiptarë të vrarë nga formacionet e ushtrisë gjermane.
- Numri i qytetarëve shqiptarë të vrarë nga formacionet partizane/komuniste është 2.1 herë më i madh se numri i qytetarëve shqiptarë të vrarë nga formacionet ushtarake nacionaliste.
- Formacionet partizane/komuniste kanë vrarë më shumë shqiptarë se dy ushtritë pushtuese, italiane dhe gjermane, të marra së bashku.
- Fakti që ushtria partizane/komuniste ka vrarë më shumë shqiptarë sesa dy ushtritë e huaja është një tregues serioz për të kuptuar se kundër kujt ishte mobilizuar më shumë ajo ushtri.

¹ *Historia e shqiptarëve gjatë sheklullit XX (1939-1944)*, Vëll. IV (Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2021), 442.

- Në tabelën 1, te palët ndërluftuese ka një kategori të emërtuar “gjermano-ballistë”, e cila nuk ka ekzistuar realisht. Nuk ka dokumente me vlerë juridike që të provojnë ekzistencën e formacioneve të tilla.
- Të vrarët në tabelën 1 kanë statusin e dëshmorit të atdheut, dhënë nga strukturat e regjimit komunist, sipas drekretit nr.4558, datë 18.10.1969 “Për dëshmorët e Atdheut”.
- Të vrarët në tabelën 2 nuk u regjistruan as për statistika gjatë regjimit.
- Referuar statistikave, me largimin e ushtrisë italiane dhe gjermane nga Shqipëria, njëra më 1943 dhe tjera më 1944, Shqipëria ra nën kontrollin e formacionit ushtarak që e kishte dëmtuar popullsinë e saj më shumë gjatë luftës.

PËRFUNDIME

Indiferenca e institucioneve shtetërore për disa dekada ndaj të vrarëve nga partizanët/komunistët në periudhën 1 janar 1942 – 29 nëntor 1944 është një njollë për shtetin shqiptar, dëshmi e karakterit antihuman të regjimit komunist, dhe pengesë për mbylljen e plagëve të përçarjes dhe realizimit të pajtimit kombëtar

Formacionet ushtarake partizane/komuniste kanë shkaktuar numrin më të madh të viktimave ndër qytetarët shqiptarë. Ato nuk janë vrasje rastësore dhe tregojnë se objektivi kryesor luftarak i ushtrisë partizane kanë qenë formacionet politike dhe ushtarake shqiptare, jo komuniste.

Lufta e forcave ushtarake partizane/komuniste nuk ka qenë një luftë çlirimtare, por një luftë ideologjike për pushtet. Faktet flasin vetë, viktimat e luftës ideologjike janë më të shumta se viktimat e luftës çlirimtare.

Përderisa Kuvendi i Shqipërisë ka njohur pafajësinë e të vrarëve nga partizanët/komunistët, atëherë duhet të vazhdojë me hapa të tjerë plotësues për mbylljen e plagëve të së shkuarës, për të realizuar përfundimisht pajtimin e shoqërisë, të cilën e përçau brutalisht, për një kohë të gjatë, lufta civile dhe e thelloi lufta e klasave, të dyja të ideuara dhe organizuara nga PKSH/PPSH.

REKOMANDIME

Në përfundim të këtij raporti informues, ISKK rekomandon që Kuvendi i Shqipërisë:

1. Të njohë me një rezolutë të veçantë viktimat shqiptare të shkaktuara nga ushtria partizane/komuniste gjatë luftës.
2. Të njohë me rezolutë faktin e luftës civile dhe t’u kërkojë institucioneve përkatëse ta pasqyrojnë luftën civile në tekstet e historisë.
3. Të trajtojë ligjërisht gjithë të vrarët gjatë Luftës së Dytë Botërore me të njëjtin status dhe t’u sigurojë të njëjtat nderime institucionale.
4. T’i kërkojë Këshillit të Ministrave të shpallë një ditë zie kombëtare në nderim të viktimave të luftës civile.

Bibliografi:

Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. I (ISKK: Tiranë, 2012)

Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. II (ISKK: Tiranë, 2013)
Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. III (ISKK: Tiranë, 2014)
Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. IV (ISKK: Tiranë, 2015)
Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. V (ISKK: Tiranë, 2016)
Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. VI (ISKK: Tiranë, 2017)
Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. VII (ISKK: Tiranë, 2018)
Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. VIII (ISKK: Tiranë, 2019)
Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. IX (ISKK: Tiranë, 2020)
Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. Shtesa 1 (ISKK: Tiranë, 2021)
Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. Shtesa 2 (ISKK: Tiranë, 2022)
Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist, vëll. Shtesa 3 (ISKK: Tiranë, 2023)

DREJTORI EKZEKUTIV

Çelo Hoxha

